

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe mr.sc Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Doganat e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër të paditurve: N.S., nga komuna e Vitisë, E.G., nga Ferizaj, H.B., nga komuna e Ferizajt dhe A.S., nga komuna e Kaçanikut, të cilët i përfaqëson M.S., avokat nga Prishtina - të paditurin H.B., me autorizim dhe të paditurit tjerë si përfaqësues i përkohshëm i tyre, për kompensimin e dëmit, përkritazi me revizionin e të paditurit E.G., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1195/2013, datë 07.12.2015, në seancën e mbajtur më 13 mars 2016, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar revizioni i paditësit E.G., nga Ferizaj, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1195/2013, datë 07.12.2015.

### **A r s y e t i m**

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1195/2013 datë 07.12.2015, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komonale Prishtinë, C.nr. 611/2005, datë 24.01.2012, në pjesën miratuese të tij - paragrafi 1 i dispozitivit. Me pjesën II të dispozitivit, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komonale Prishtinë, C.nr. 611/2005, datë 24.01.2012 në paragrafin 2 të dispozitivit të tij, në pjesën që i referohet kamatës së pranuar mbi shumat e gjykuara, ashtu që paditëses, Doganat e Kosovës me seli në Prishtinë, mbi shumën totale të të aprovuar prej 73.475,00 €, i është pranuar kamatëvonesa ligjore sipas normës së kamatës të cilën e paguajnë bankat e Kosovës për mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë (24.01.2012), deri në pagesën definitive, nën kanosje të përmbarimit me detyrim.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri E.G., përmes të autorizuarit të tij av. S.N., nga Prishtina, me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dyja gjykatave të ndryshohen apo të prishen dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet, kurse çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka kërkuar me padinë e parashtruar që të detyrohen katër të paditurit e përmendur më sipër që t'ia kompensojnë dëmin material në shumën totale prej 73.475,00 €, me kamatë dhe këtë: N.S. - 40.475,00 €, E.G. - 11.000,00 €, H.B. - 11.000,00 € dhe A.S. - 11.000,00 €, të shkaktuar përmes veprës penale të kryer prej tyre, siç vërtetohet nga aktgjykimi penal i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr. 627/2003, datë 21.1.2004 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 218/2004, datë 23.09.2004.

Të paditurit, përmes avokatit M.S, nuk e kanë kontestuar kërkesëpadinë e paditëses, por kanë kërkuar që nga vlera e përgjithshme e taksës doganore, me të cilën është dëmtuar paditësja, të zbriten shumat e sekuestruara nga të paditurit: H.B. - 7.500 €, E.G. - 8.670 € dhe A.S. - 5.000 €, sepse taksa doganore nuk mund të paguhet dy herë.

Gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në faktet jokontestuese mes ndërgjyqësve dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 218/2004, datë 23.09.2004, sipas të cilit veprimet e të akuzuarve, këtu të paditurve, cilësohen si vepër penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare (neni 339 par. 3, lidhur me par. 1 dhe neni 23 të LPK), për të cilën katër të akuzuarit, këtu të paditurit, janë shpallur fajtorë dhe janë gjykuar me nga 4 (katër) vjet burgim, me zbatimin e nenit 154 të LMD ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurve.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga një gjendja e tillë e çështjes, gjeti se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt

dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurve.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Në mbështetje të gjendjes së përshkruar të çështjes, kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë argumente të mjaftueshme në mbështetje të konstatimeve të saj lidhur me aktgjykimin e goditur. Faktet që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë nuk vihen në dyshim nga thëniet në revizion, ndërkaq provat e tjera të analizuar më hollësisht nga gjykata e shkallës së dytë i materializojnë konstatimet e saj lidhur me detyrimin e të paditurit për kompensimin e dëmit, pasi që me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 218/2004, datë 23.09.2004, i padituri është shpallur fajtor për bashkëkryerje të veprës penale shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit, parashikuar nga neni 339 par. 1. 3 , lidhur me par. 1 dhe neni 23 të LPK, për të cilën katër të akuzuarit, në mesin e tyre edhe i padituri, janë shpallur fajtorë dhe janë gjykuar me nga 4 (katër) vjet burgim. Gjukata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt se ekziston përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë (neni 154 i LMD), i cili i është shkaktuar paditëses me veprimet e kundërligjshme të të paditurit.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në bazë të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale në dëm të të paditurit E.G., pasi është vërtetuar vetëm vlera e naftës së importuar në shumën prej 8.670,00 €, pa u bërë vlerësimi i saktë ligjor i shumës së dëmshpërblimit, të cilën i padituri E.G. duhet t'ia paguajë paditëses, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme, për faktin se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se shumat e aprovuara për secilën të paditur veç e veç paraqesin një shpagim real për dëmin që i është shkaktuar paditëses përmes veprës penale të kryer nga i paditurit N.S., pronar i firmës private, dhe të akuzuarit E.G., H.B., dhe A.S., si persona zyrtarë (punonjës të Doganës), të cilit me qëllim që t'i sjellin vetes përfitim pasuror të kundërligjshëm, sipas marrëveshjes, kanë tejkaluar autorizimet zyrtare, duke kaluar pa taksa doganore gjashtë maune me benzinë (në sasi prej 180.699 litra), pronë e të akuzuarit N.S., duke dëmtuar kështu buxhetin e konsoliduar të Kosovës me 74.475,00 €. Për më tepër, i autorizuari i të paditurit E.G., nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses as në bazë, as në sasi, por ka kërkuar që nga vlera e përgjithshme e taksës doganore, me të cilin është dëmtuar paditësja, të zbriten shumat e sekuestruara nga i padituri E.G. në shumë prej 8.670,00 €.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë i cilësoi si të papranueshme parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, as shkelje të cilat pretendohen në revizion. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, pa kundërthënie dhe në përputhje të plotë me arsyetimin, i cili përmban arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante, të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë, prandaj konsiderohet se me pretendimet e ngritura në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore aktgjykimi i goditur nuk mund të vihet në pikëpyetje.

Në revizion përsëriten çështjet që kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi i të dy gjykatave dhe ato kanë të bëjnë me detyrën e gjykatës së shkallës së dytë për të vlerësuar nëse vlera e sekuestruar e mallit është dashur të llogaritet në kuadër të sasisë së dëmit për shpërblimin e të cilit është ngarkuar paditësi, duke sqaruar karakteristikën e mallit të sekuestruar dhe të dëmit; të gjitha këto parashtrime u treguan të pasuksesshme dhe pa ndikim në marrjen e një vendimi tjetër për këtë çështje, për arsyet e paraqitura nga të dyja gjykatat, që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë, pa pasur nevojë të përsëriten këtu edhe njëherë.

Nga sa u parashtrua dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËSPRISHTINË

Rev.nr. 59/2016, datë 13 mars 2016

Kryetare e kolegjit,  
Gyltene Sylejmani